



19.06.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Implementimi dhe zbatimi i procedurave të lidhura me veprimet që gjenerojnë shpenzime dhe ose të ardhura dhe garantimi i përputhshmërisë me ligjin
2. Zbatimi i buxhetit vjetor të institucionit dhe të gjitha vendimeve financiare
3. Rregjistrimi i të ardhurave
4. Rregjistrimi i shpenzimeve sipas ligjit brenda vitit financiar
5. Mbajtja e inventareve
6. Kontrolli i magazines dhe levizjeve të vlerave monetare dhe materialeve në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe legjislacionin në fuqi
7. Ndjekja dhe llogaritja e të gjitha shpenzimeve të institucionit, sipas zerave të buxhetit

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në "Shkenca ekonomike";
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në fushën financiare në sektorin publik apo privat.
- c- Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx

- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë

- Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër:

1- Do të bëhet ne Zyren e Administres te Bashkise Permet

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 13.06.2025

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 26.02.2025, Njësia e burimeve njerëzore do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë listën e kandidateve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkurrimi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në Bashkinë Permet, në rrugë elektronike e-mail, telefonike për shkaqet e mos kualifikimit .

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7661 “Për kontabilitetin” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9228 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9136 “Per menaxhimin financiar e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë fituesin në portalin Sherbimi Kombëtar i Punesimit dhe ne stendat e informimit publik.

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni, duke filluar nga data 14.06.2025.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" indryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në "Shkenca Ekonomike";
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në fushën ekonomike në sektorin publik apo privat.
- c- Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx

b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f – Vërtetim për gjendjen gjyqësore;

g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të behet pranë Zyres së Administratës pranë Bashkisë Permet.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 19.06.2025

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20.06.2025** , Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në portalin Sherbimi Kombëtar i Punësimit dhe në stendat e informimit publik, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJMBNJ, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7661 "Për kontabilitetin" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9228 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9136 "Për menaxhimin financiar e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a-Vlerësimin me shkrim deri në 60 pikë
- b-Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë
- c-Jetëshkrimin që konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës dhe trajnimeve të lidhura me fushën deri në 15 pike

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail, telefonit etj.)

**NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE
BASHKIA PËRMET**